

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Anita Krasniqi Prenaj, me sekretaren juridike Fexhrie Tashevcin, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.Th., i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore nga Prishtina, PP.nr.2436/16, të dt.30.01.2017, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën Prokurorisë Themelore në Prishtinë për dhënien e urdhrin ndëshkimor: dënim me gjobë, me datë 07.09.2017, mori:

A K T G J Y K I M

Pranohet Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.nr.2436/16, të dt.30.01.2017, gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari: E.TH., i biri i E., lindur me datë ..., me vendbanim në fshatin Ll. Komuna e G., me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datë 02.05.2016, rreth orës 22:30, në rrugën Sllatinë-Fushë Kosovës, i pandehuri deri sa ka qenë duke ke drejtuar automjetin e tipit “Mercedes”, me targa të regjistrimit ..., ngjyrë e kaltër, nga pakujdesia ka shkelë ligjin mbi trafikun publik, ka rrezikuar jetën dhe ka dëmtuar trupin e njeriut, në atë mënyrë që ka vepruar në kundërshtim me nenin 126 të LSKRR-së, duke mos ja përshtatur shpejtësinë e lëvizjes së automjetit kushteve në rrugë, duke mos mbajtur distancën e sigurisë në mes të automjeteve, me të arritur në fshatin B., i njëjti me pjesën e përparme e godet në pjesën e pasme automjetin e tipit “Opell Astra”, me targa të regjistrimit ..., me ngjyrë të kaltër, të cilin e drejtonte R.N., me ç’rast lëndime të lehta trupore pëson tani i dëmtuari G.C..

Me këtë ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform neneve 7, 17, 21, 41, 43, 46 të KPRK, si dhe neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, shqipton këtë:

DËNIM ME GJOBË

I akuzuari **E.TH.**, dënohet me gjobë në shumë prej **300.00€ (treqind euro)**, të cilën obligohet ta paguaj me 3 (tri) këste në afatin ligjorë nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20€ të gjobës.

Obligohet i akuzuari që të paguajnë shpenzimet procedurale për ekspertizën mjeko ligjore shumë prej 20.00€, për ekspertizën e komunikacionit shumë prej 40.88€ si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20€, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohet në kontest juridiko – civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.nr.2436/16, të dt.30.01.2017, ka akuzuar E.Th., se ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par 1 të KPRK-së, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i akuzuari.

Gjyqtari i çështjes me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493 të KPPK, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, e posaçërisht ekspertiza e ekspertit të komunikacionit Ing. A.S., të datës 26.08.2016, dhe ekspertiza mjeko ligjore e Dr. M.G., të dt: 02.12.2016, si dhe shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohen.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës dhe paushallit gjyqësor u mor konform nenit 450 të KPPK.

Vendimin për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest juridiko – civil, gjykata e mori në bazë të nenit 463 par. 2, të KPP RK-së.

Nga sa u tha më lartë në bazë të neneve 365 dhe 495 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË P.nr.417/17, të datës 07.09.2017

**Procesmbajtësja,
Fexhrie Tashevi**

**G j y q t a r j a
Anita Krasniqi Prenaj**

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në këtë gjykatë.